

**VENDIM**  
**Nr. 174, datë 18.5.2023**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“PROINFINIT CONSULTING” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË**  
**ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1378/1 prot., datë 17.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1378 prot., datë 8.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “b” dhe “d” dhe për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “b”.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin, dokumentacionin si vijon:

- strukturën organizative;
- informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në gwh) të parashikuar për t’u furnizuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës;
- planin e biznesit;
- informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, me adresat përkatëse të vendndodhjes së tyre;
- informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët;
- gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion në lidhje me kontratën e qirasë, duke saktësuar që afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate duhet të mbulojë të gjithë periudhën 5-vjeçare të licencimit.
- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi, të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM  
ANËTARE E BORDIT  
**Erjola Sadushi**